



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:211834

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05652496

KPPP.nr. 1591/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Raiffesien Bank Kosovë (RBKO), me seli në Prishtinë, rr. “Robert Doll”, nr. 99, kundër debitorëve: 1. “A.T.” B.I., me numër unik identifikues 811304188 dhe seli në Kaçanik, rr. “Sali Bajra”, p.n. Lagjia e re; 2. A.T. me numër personal ... dhe adresë në Kaçanik, Lagjia e re, dhe; 3. D.L. me numër personal ... dhe adresë në Kaçanik, Lagjia e re, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit A.T. ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 447/23, i lejuar me datë 20.09.2023, nga Përmbartuesi Privat Besnik F. Nuhiu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 03.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit A.T. B.I nga Kaçaniku, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 447/23, i lejuar me datë 20.09.2023, nga Përmbartuesi Privat Besnik F. Nuhiu, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Raiffeisen Bank Kosovë, mbi bazën e dokumentit përmbartimor, Marrëveshjes mbi Pengun e datës 09.02.2021, për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja e kredisë nr. 200728277 dhe Marrëveshja mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e visa biznes kredit kartelës e datës 15.02.2021, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 447/23, të datës 20.09.2023, me të cilin janë detyruar debitorët që, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimi të urdhrit, të paguajnë shumën prej 7,952.31 EUR, me kamatë të rregullt dhe kamatëvonesë, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, përmes bllokimit të xhirollogarive bankare të debitorëve, apo përmes sekuestrimit të kolateralit të lënë peng.

Debitori A.T., brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se ka pranuar vetëm propozimin për përparim dhe urdhrin përmbartimor, ndërsa jo edhe dokumentet përmbartimore, me çka është në kundërshtim të plotë me nenin 40, par. 1, pika 1.3 të LPP-së, respektivisht propozimi duhej të kishte të bashkangjitur dokumentin përmbartimor në origjinal apo kopje të vërtetuar. Ka shtuar se me kreditorin janë në negociata me qëllim të ri programimit të borxhit, e për arsye ekonomike ka rënë në vonesë. Duke qenë se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për lejimin e urdhrin për përmbartim për shkak të të metave, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim për shkak se nuk janë të mbështetura në prova në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së. Ndërsa, ka shtuar se në propozimin për përmbartim janë bashkangjitur dokumentet përmbartimore me të cilat është iniciuar procedura përmbartimore dhe se procedura është zhvilluar në përputhje me dispozitat e LPP-së. Duke qenë se qëllimi i debitorit është prolongimi i procedurës, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së: “*Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”, ndërsa me nenin 5, paragrafi 2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se dokument përmbartues paraqet: “*...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...*”.

Tutje, sipas nenit 38, paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, *Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit*

*dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.*

Gjykata, duke ju referuar dispozitave të cekura si më lartë, gjeti se dokumenti, përkatësisht Marrëveshja mbi Pengun e datës 09.02.2021, për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja e kredisë nr. 200728277, e mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor nga ana e përmbaruesit privat, nuk është deponuar në origjinal apo kopje të vërtetuar siç kërkohet me nenin 38 të LPP-së.

Përkundër kësaj, Përmbaruesi Privat si organ përmbarues në këtë çështje përmbarimore nuk ka vepruar në përputhje me nenin 38, par.2 të LPP-së me të cilin parashihet se *“Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.”*

Në këtë drejtim, referuar nenit 43, par.4 të LPP-së i cili përcakton se *“Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrit të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”,* gjykata gjen se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbarim nuk i është bashkangjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit përmbarimor.

Gjykata pati parasysh pretendimin e kreditorit se në rastin konkret, Certifikata për Regjistrimin e Pengut lëshohet në mënyrë elektronike nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe si e tillë në bazë të Ligjit nr. 04/L-136 për Regjistrimin e Pengut në Regjistër për Sendet e Luajtshme shërben si titull ekzekutiv, por që në rastin konkret, me nenin 22, par.1, nën-par. 1.7a të Ligjit për Procedurën Përmbarimore si dokument përmbarues përcaktohet *“kontrata për pengun e regjistruar në regjistrat e pengut”*, andaj në rastin konkret, titull ekzekutiv paraqet marrëveshja mbi pengun e cila duhet të jetë e regjistruar, e rrjedhimisht, në kuptim të nenit 38, par.1 të LPP-së, marrëveshja e pengut si dokument përmbarimor duhet paraqitur në origjinal apo kopje të vërtetuar nga origjinali, ndërsa të njëjtës duhet bashkangjitur konfirmimi mbi regjistrimin e

pengut në formë elektronike, ashtu siç e parasheh neni 3, par. 1.15 i Ligjit nr. 04/L-136 për Regjistrimin e Pengut në Regjistër për Sendet e Luajtshme.

Gjykata mori parasysh se dokumenti përmbartimor, përkatësisht Marrëveshjet e pengut mbi bazë e së cilave është lejuar urdhri përmbartimor mbajnë vulën e saktësisë së lëshuar nga ana e kreditorit, mirëpo gjeti se vendosja e vulës së tillë nga ana e kreditorit të njëjtave dokumente nuk ia jep tiparet e dokumentit të vërtetuar nga origjinali, ngase për vërtetësinë e kopjes nga origjinal kompetent është organi noterial dhe atë në kuptim të nenit 47.1 të Ligjit për noterinë.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1591/23, datë 03.05.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.